



▶ Dokument politik

Hapësira fiskale për mbrojtjen sociale në Shqipëri: përditësim i vitit 2022

1. Hyrje

Në një kohë të shenjuar nga pasiguri kaq të mëdha, nevoja për krijimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe elastik për mbrojtjen sociale nuk ka qenë kurrë më e madhe. Qeveritë e vendeve të ndryshme duhet të studiojnë mundësinë e zbatimit të të gjitha masave të mundshme për të zgjeruar hapësirën fiskale me qëllim mbështetjen e OZhQ-ve dhe të agjendës për zhvillimin kombëtar përmes ofrimit të vendeve të punës dhe mbrojtjes sociale.

Në vitin 2021 ILO mori përsipër kryerjen e analizës së hapësirës fiskale për sistemin e mbrojtjes sociale në Shqipëri si dhe të vlerësimit të sistemit të mbrojtjes sociale në kuadër të Programit të Përbashkët të OKB-së “Katalizimi i Mbrojtjes Sociale në nivel Bashkiak”.¹ Analiza e hapësirës fiskale u bazua në të dhënat ekzistuese për vitet 2015-2019. Kjo analizë kishte si qëllim kryesor ofrimin e orientimit të përgjithshëm për qeverinë, partnerët socialë dhe palët e tjera të interesuara në nivel kombëtar dhe lokal për mobilizimin e burimeve për financimin e mbrojtjes sociale gjatë rrjedhës normale të jetës.

Goditja e dyfishtë me të cilën u përball Shqipëria – tërmetet e nëntorit të vitit 2019 dhe pandemia COVID-19 gjatë periudhës 2020-2022 – preku në mënyrë të konsiderueshme ekonominë, tregun e punës dhe financat publike. Për më tepër, presionet inflacioniste për shkak të luftës në Ukrainë e kanë lënë në hije rimëkëmbjen ekonomike pas pandemisë. Të gjithë këta faktorë ndikojnë në kapacitetet kombëtare për të gjeneruar financime të mjaftueshme për mbrojtjen sociale dhe për të shkuar drejt një qëllimi afatgjatë për mbrojtjen sociale universale.

Në këtë kontekst, në kuadrin e Programit të Përbashkët të OKB-së “Opsionet e Politikave Strategjike për Financimin e OZhQ-ve”, ILO u angazhua për përditësimin e analizës së hapësirës fiskale duke marrë parasysh të dhënat e reja në dispozicion që mbulojnë periudhën e pandemisë COVID-19. Ky dokument politik bën një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore si dhe evidenton ndryshimet kryesore që kanë ndikuar në mundësinë e vendit për të krijuar hapësirë fiskale për mbrojtjen sociale.

1. ILO. 2021. Hapësira fiskale për financimin e mbrojtjes sociale në Shqipëri.

ILO. 2021. Analiza e sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri: mbulimi, shpenzimet, përshtatshmëria dhe financimi.

2. Konteksti ekonomik nga viti 2019 deri në vitin 2022

Tërmetet e vitit 2019 dhe pandemia COVID-19 patën ndikim të thellë në ekonominë shqiptare. Në përgjigje të pandemisë COVID-19, qeveria shqiptare miratoi një sërë masash, duke përfshirë edhe alokimin e buxhetit shtesë për shëndetin publik, mbështetjen ekonomike të punëtorëve dhe bizneseve të prekura nga pandemia, si dhe ndihmën në para dhe mbështetjen urgjente humanitare për familjet e varfra dhe në nevojë.² Kostoja e tre paketave kryesore mbështetëse arriti në masën 3.6% të PBB-së.

Në vitin 2020, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) në Shqipëri u tkurr me 3.5%, por më pas në vitin 2021 shënoi një rritje me 8.5%. Në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2022, PBB-ja u rrit përkatësisht me 6.5% dhe 2.2%. PBB-ja për frymë ra me 2.9% në vitin 2020, por u rrit me 9.6% në vitin 2021. Sipas Bankës Botërore, rimëkëmbja e shpejtë shpjegohet me nxitjen e politikave nga ana e qeverisë dhe dinamikën e vërejtur në sektorët e konsumit dhe industrisë, përfshirë punimet për rindërtimin dhe përballimin e pasojave të tërmetit.

Rimëkëmbja e tregut të punës ka mbetur prapa. Sipas të dhënave të dala nga Anketa e Forcave të Punës, norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vitin 2020 u regjistrua në masën 59.5% (66.9% për meshkujt, 52.3% për femrat), 0.9 pikë përqindje më e ulët se viti i mëparshëm dhe, megjithë rikuperimin e vërejtur që nga viti 2021, këto norma ende nuk kanë arritur të jenë në nivelin e periudhës para pandemisë. Normat e papunësisë u rritën me 0.2 pikë përqindje në vitin 2020 duke kapur vlerën prej 11.7% (11.5% për meshkujt, 11.9% për femrat). Që atëherë, ndryshe nga vitet e mëparshme, shkalla e papunësisë së femrave ka qenë vazhdimisht më e lartë se ajo e meshkujve.

Dy goditjet e lartpërmendura patën ndikim të konsiderueshëm edhe mbi financat publike. Për shkak të shpenzimeve emergjente për marrjen e masave në përgjigje të krizave me të cilat po përballej vendi, deficitin fiskal si përqindje e PBB-së u zgjerua nga 1.9% në vitin 2019 në 6.7% në vitin 2020 dhe në 4.5% në vitin 2021, gjë që çoi në rritjen e niveleve të financimit të deficitit. Që nga viti 2015, niveli i borxhit publik ishte ulur me pothuajse 7 pikë përqindje në 65.8% të PBB-së në vitin 2019. Megjithatë, për shkak të pandemisë COVID-19, borxhi publik i llogaritur si përqindje e PBB-së arriti nivelin e tij maksimal në 74.5% në vitin 2020, duke u ulur në 73.2% në vitin 2021. Për pasojë, shërbimi i borxhit (pagesa e principalit dhe interesit) u rrit ndjeshëm nga 3.8% e PBB-së në vitin 2019 në 5.9% në vitin 2020, duke u ulur më pas në 3.9% në vitin 2021.

Që nga fillimi i vitit 2022, është vënë re një rritje e presionit inflacionist. Ndërsa norma mesatare e inflacionit gjatë periudhës 2015-2019 ishte 1.9% në vit, në shtator të vitit 2022 ajo u regjistrua në masën 8.1% shoqëruar me rritje të konsiderueshme të çmimit të ushqimeve (14.0%) dhe transportit (17.2%).

Rimëkëmbja e dobët e tregut të punës dhe përkeqësimi i financave publike kanë çuar në kufizime të mëtejshme të financimit të mbrojtjes sociale nëpërmjet uljes së bazës tatimore dhe presionit fiskal për të frenuar rritjen e deficiteve fiskale dhe borxheve publike. Nga ana tjetër, inflacioni i përshpejtuar ndikon në kostot e jetesës dhe nivelet e varfërisë dhe mund të kërkojë rregullime shtesë të pagave dhe përfitimeve nga skemat e mbrojtjes sociale.³

2. ILO. 2021. Vlerësimi i Masave të Sigurimeve Shoqërore në Përgjigje të COVID-19: Mësime nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Lindore gjatë fazës së parë të pandemisë.

3. Si reagim ndaj rritjes së shpejtë të çmimeve të ushqimeve dhe energjisë në vitin 2022, qeveria ka ofruar mbështetje emergjente për pensionistët që marrin pensione të ulëta, familjet përfituese të Ndihmës Ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, si dhe subvencione për çmimin e energjisë, në kuadër të dy Paketave të Rezistencës Sociale.

3. Përditësimi i analizës së hapësirës fiskale

Duke marrë parasysh tendencën ekonomike të vërejtur vitet e fundit, për krijimin e hapësirës fiskale për mbrojtjen sociale janë rivlerësuar disa opsione të ndryshme financimi. Tabela 1 bën një krahasim të rezultateve të dala nga përditësimi i kryer për vitin 2022 krahasuar me të dhënat e dala nga raporti i vitit 2021 (shih Këndin Informativ më poshtë).

Tabela 1. Opsionet e financimit dhe efektet e tyre, përditësim i vitit 2022

Opsionet e financimit	Masat	Efektet fiskale (% e PBB-së)	
		Raporti i vitit 2021	Përditësim i vitit 2022
Zgjerimi i mbulimit të sigurimeve shoqërore dhe të ardhurave kontributive	Mbulimi universal i punëtorëve	5.8	4.65
Rritja e të ardhurave tatimore	TVSH, 1 pikë përqindje shtesë	0.44	0.41
	Tatim fitimi, +1 pikë përqindje	0.20	0.18
	Akciza, +1 pikë përqindje	0.28	0.27
	Tatimi mbi të ardhurat personale, +1 pikë përqindje	0.16	0.14
	Taksat kombëtare dhe të tjera, +1 pikë përqindje	0.28	0.22
	Detyrimet doganore, +1 pikë përqindje	0.06	0.05
	Ulje me 16% e evazionit fiskal	1.1	0.85
	Ulje me 20% e shpenzimeve tatimore	1.1	1.1
Eliminimi i flukseve të paligjshme financiare	Ulje me 20% e flukseve të paligjshme	0.95-1.36*	0.80-1.17
Riprioritizimi i shpenzimeve publike	10% ri-prioritizim	0.05	0.04
Përdorimi i rezervave fiskale dhe valutore	20% e rezervave të tepërta sipas skenarit më të kufizuar	0.40	0.40
Ristrukturimi i borxhit	Rënie me 1% e kostos mesatare të borxhit shqiptar	0.56	0.78
	Ulje me 5% në shërbimin e borxhit	0.39	0.24
	Rënie me 10% në pagesat e interesit	0.22	0.21
	Ulje me 5% në kreditë publike dhe të garantuara publikisht pranë institucioneve financiare ndërkombëtare	0.43	0.40
	Ulje me 5% e borxhit shumëpalësh	0.36	0.89
Miratimi i një politike makroekonomike akomoduese	Fiksimi i deficitit fiskal në nivelin 2% të PBB-së	0.40	Nuk është marrë parasysh

Burimi: Vlerësimet e vetë ILO-s.

*Shënim: Vlerësimet pasqyrojnë rregullimin thelbësor të të dhënave retrospektive.

Në përgjithësi, ndikimi i tërmetit dhe pandemisë COVID-19 mbi mundësinë e krijimit të hapësirës shtesë fiskale për mbrojtjen sociale ka qenë negativ. Në total, 13 nga 18 masat individuale të shqyrtuara në këtë analizë kanë patur më pak ndikim mbi mundësinë e krijimit të hapësirës fiskale krahasuar me raportin e mëparshëm. Megjithatë, rezultatet flasin edhe për qëndrueshmëri, në kuptimin që rendi i efektivitetit të masave individuale mbetet i pandryshuar.

Më poshtë gjeni disa çështje specifike që duhet të shpjegohen më me hollësi.

- ▶ Opsionet që gjenerojnë të ardhura të drejtpërdrejta, zakonisht nëpërmjet kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave, kanë ende potencial të konsiderueshëm për të krijuar hapësirë fiskale për sigurimet shoqërore kontributive dhe ndihmën sociale jo kontributive dhe shërbimet sociale. Megjithatë, për shkak të uljes së normës së punësimit dhe tkurrjes së PBB-së, efektiviteti i tyre është zvogëluar dukshëm. Si rrjedhim, opsionet që gjenerojnë të ardhura të drejtpërdrejta kërkojnë angazhimin në përpjekje të mëtejshme për të zgjeruar financimin e mbrojtjes sociale.
- ▶ Opsionet për përmirësimin e efikasitetit dhe menaxhimit të shpenzimeve përfshijnë reduktimin e flukseve të paligjshme të financimit, ripërcaktimin e prioriteteve në aspektin e shpenzimeve dhe ristrukturimin e borxhit. Përsëri, në këto opsione u vu re një rënie e konsiderueshme, ndërkohë që ulja e flukseve të paligjshme financiare mbetet ende si mundësi për krijimin e fondeve të konsiderueshme.
- ▶ Performanca e fundit buxhetore dhe alokimi i burimeve publike ka reduktuar ndjeshëm mundësinë e krijimit të hapësirës fiskale nga rialokimi i shpenzimeve. Hapësira për zgjerimin e buxhetit në lidhje me kompensimet, transfertat dhe shpenzimet kapitale ende ekziston, por rialokimi funksional i buxhetit është përballur me një reduktim të potencialit të tij për krijimin e hapësirës fiskale. Për më tepër, rezervat e tepërta mbeten po aq efektive edhe pse përdorimi i tyre për përfitime nga skemat e mbrojtjes sociale mund të përballet me kufizime ligjore.
- ▶ Në vitin 2021, shërbimi i borxhit u kthye në nivelin e regjistruar para periudhës së pandemisë. Disa alternativa për menaxhimin e borxhit, për shembull, rënia prej 1% e kostos mesatare të borxhit shqiptar dhe ulja prej 5% e borxhit shumëpalësh mund të gjenerojnë hapësirë shtesë për mbrojtjen sociale, megjithëse krahasuar me pesë vite më parë ulja e kostos mesatare është më e vështirë, pasi raporti i borxhit publik ndaj PBB-së është më i madh. Gjithashtu, vlen të theksohet se borxhi afatshkurtër pësoi një rënie të ndjeshme duke përfaqësuar vetëm 14% të rezervave të vendit krahasuar me nivelin e mëparshëm prej 50%, kështu që pagesa e interesit më të ulët mund të kontribuojë në uljen e borxhit të përgjithshëm.
- ▶ Dhe e fundit, si një opsion për miratimin e një politike makroekonomike më akomoduese, raporti i vitit 2021 sugjeroi marrjen e një mase që lejon ekzistencën e deficiteve të caktuara fiskale, për shembull në masën 2% të PBB-së, në mënyrë që vendi të mund të rrisë burimet për mbrojtjen sociale pa rrezikuar stabilitetin makroekonomik. Megjithatë, në nivelet aktuale të borxhit publik dhe presioneve inflacioniste, ky opsion nuk konsiderohet i realizueshëm. Ky opsion mund të rishikohet vetëm me stabilizimin e inflacionit dhe mbajtjen nën kontroll të nivelit të borxhit.

Realizueshmëria e të gjitha alternativave të financimit duhet të vlerësohet nga këndvështrime sa më të gjera. Së pari, efektet ekonomike të secilës masë duhet të vlerësohen duke patur parasysh aspekte të tilla si qëndrueshmëria, promovimi i barazisë dhe rritja e mirëqenies. Së dyti, zbatimi efektiv i këtyre masave kërkon qasjen tek kapacitetet e institucioneve shqiptare, duke përfshirë burimet njerëzore, financiare dhe informatike, si dhe strategjitë e mirë-ideuara. Së treti, është po aq e nevojshme të vlerësohet mënyra se si këto masa mund të marrin mbështetje nga palë të ndryshme të interesuara, të cilët mund të kenë interesa konfliktuale. Duhet theksuar gjithashtu se disa nga masat si formalizimi i ekonomisë informale, kontrolli i evazionit fiskal dhe lufta kundër flukseve të paligjshme financiare mund të sjellin të ardhura të konsiderueshme vetëm pas disa vitesh përpjekje të vazhdueshme, ndoshta edhe për më shumë se një dekadë.

Këndi Informativ. Hapësira fiskale për mbrojtjen sociale: Koncepti dhe opsionet

Hapësira fiskale përkufizohet si burimet ekzistuese në dispozicion si rezultat i eksplorimit dhe shfrytëzimit aktiv të të gjitha burimeve të mundshme të të ardhurave nga një qeveri. Opsionet për të zgjeruar hapësirën fiskale dhe për të gjeneruar burime për mbrojtjen sociale, edhe në vendet më të varfra, janë të shumëllojshme. Tetë opsionet e financimit, të mbështetura nga deklaratat politike të Kombeve të Bashkuara dhe institucioneve financiare ndërkombëtare, janë si më poshtë:

1. Zgjerimi i mbulimit të sigurimeve shoqërore dhe të ardhurave kontributive;
2. Rritja e të ardhurave tatimore;
3. Eliminimi i flukseve të paligjshme financiare;
4. Rishpërndarja e shpenzimeve publike;
5. Përdorimi i rezervave valutore fiskale dhe rezervave të bankës qendrore;
6. Menaxhimi i borxhit: huamarrja ose ristrukturimi i borxhit sovran;
7. Rritja e ndihmave dhe transfertave;
8. Miratimi i një kuadri makroekonomik më akomodues.

Burimi: Ortiz, I. *et. al.* 2019. Hapësira Fiskale për Mbrojtjen Sociale: Manual për Vlerësimin e Opsioneve të Financimit. ILO, UNWOMEN.

4. Financimi në nivel bashkie dhe mbrojtja sociale

Si rezultat i decentralizimit fiskal dhe administrativ të Shqipërisë që filloi në vitin 2015,⁴ një pjesë e madhe e administrimit dhe financimit të ndihmës sociale dhe shërbimeve sociale është transferuar nga pushteti qendror tek pushteti vendor (61 bashki).

Pushteti vendor, në veçanti administratorët shoqërorë, luajnë tani një rol kyç sa i takon identifikimit të familjeve që kanë nevojë për ndihmë ekonomike në para, verifikimit të informacionit të vetëdeklaruar dhe monitorimit të kushteve të jetesës së familjeve përfituese, dhe sidomos sa i takon përpjekjeve të tyre për integrimin e përfituesve në tregun e punës. Kostot e ndihmës ekonomike në para mbulohen nëpërmjet transfertave të kryera nga pushteti qendror. Megjithatë, 6% e buxhetit të ndihmës ekonomike në para u ndahet njësisë të pushtetit vendor për miratimin e përfituesve sipas gjykimit të tyre.

Pushteti vendor është përgjegjës për ofrimin dhe financimin e shërbimeve sociale. Secila bashki duhet të përgatisë planin e saj për kujdesin social ku specifikohen kostot për shërbimet dhe burimet e alokuara nga buxheti i bashkisë. Kapaciteti dhe burimet e bashkive për të ofruar shërbime të kujdesit social ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëra bashki në tjetrën. Shumë njësi të pushtetit vendor vazhdojnë të mbeten tejte të varura nga transfertat që kryhen nga buxheti i shtetit për këtë qëllim. Me qëllim garantimit e financimit të mjaftueshëm në nivel vendor për zbatimin e Planeve të Kujdesit Social, në vitin 2018 u krijua Fondi Social. Nga viti 2019 deri në vitin 2021, nga Fondi Social janë disbursuar 344.1 milionë lekë për 22 bashki. Gjithashtu, plani është që nga ky Fond të alokohen edhe 200 milionë lekë shtesë për vitin 2022.

Siç tregohet në tabelën 2, të ardhurat e pushtetit vendor shfaqin një tendencë në rritje edhe gjatë viteve të pandemisë. Të ardhurat e përgjithshme të pushtetit vendor u rritën nga 2.4% e PBB-së në vitin 2015 në 3.7% në vitin 2021. Transfertat nga pushteti qendror përfaqësojnë burimin më të rëndësishëm të të ardhurave për njësitë e pushtetit vendor, të cilat përbëjnë më shumë se 60% të të ardhurave totale. Përqindja e grantit qeveritar pësoi një rënie graduale, por u rrit gjatë viteve të pandemisë duke kapur vlerën prej 2.3% të PBB-së në vitin 2021. Taksat vendore u bënë forca shtytëse për rritjen e të ardhurave në nivel bashkiak. Gjatë pesë viteve të fundit, këto taksa u rritën me më shumë se 60%, duke arritur në 1.1% të PBB-së në vitin 2021. Taksa e pronës dhe taksa e biznesit të vogël kanë qenë të qëndrueshme që nga viti 2016.

Është e qartë se hapësira fiskale në nivelin e pushtetit vendor është e pamjaftueshme për rritjen e konsiderueshme të financimit të mbrojtjes sociale në këtë nivel. Kjo do të vazhdojë të mbetet kështu edhe me rritjen e mundshme të taksave. Për shembull, një rritje prej 20% e taksave vendore mund të gjenerojë 0.21% të PBB-së në mungesë të evazionit, ndërkohë që, sipas mendimit të disa studiuesve, mundësia e zgjerimit të mbledhjes së të ardhurave nga taksa mbi pronën mund të arrijë deri në masën 0.8% të PBB-së.

Tabela 2. Të ardhurat e pushtetit vendor sipas burimit, 2016-2021 (% PBB)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Grantet nga pushteti qendror	1.94	1.81	1.70	1.96	1.80	2.29
Taksat vendore	0.66	0.86	1.00	1.04	1.00	1.07
Taksa e pronës	0.32	0.31	0.32	0.31	0.31	0.32
Taksa e biznesit të vogël	0.04	0.02	0.02	0.02	0.02	0.02
Gjithsej	2.96	3.00	3.03	3.32	3.14	3.70

Burimi: Llogaritjet e vetë ILO-s bazuar në raportet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

4. Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

5. Përfundime

Pandemia e COVID-19 theksoi edhe njëherë rëndësinë e mbrojtjes sociale për të zbutur rreziqet që lidhen me shëndetin publik, varfërinë dhe papunësinë. Megjithatë, kriza ka nxjerrë në dritë edhe disa mangësi në sistemin ekzistues të sigurimeve shoqërore. Në veçanti, kriza e shkaktuar nga COVID-19 ka evidentuar rëndësinë e investimeve proaktive për të ndërtuar sisteme gjithëpërfshirëse dhe elastike për mbrojtjen sociale që mund t'i përgjigjen shpejt dhe në mënyrë efektive të gjitha goditjeve në momentin që ato shfaqen.

Sa i takon raportit të vitit 2011, kjo analizë e përditësuar e hapësirës fiskale ka zbuluar ndikimin negativ si të pandemisë ashtu edhe të tërmetit mbi efikasitetin e alternativave të financimit për të gjeneruar hapësirë shtesë fiskale për mbrojtjen sociale. Kështu ndodh zakonisht me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe tatimet. Ristrukturimi i borxhit ka dhënë rezultate pozitive vetëm në kushte specifike si ulja e kostos mesatare dhe ulja e borxhit shumëpalësh. Megjithatë, rritja e stokut të borxhit nuk konsiderohet politikisht e realizueshme duke pasur parasysh presionin për të kontrolluar akumulimin e borxhit. Edhe burime të tjera, si përdorimi i rezervave të tepërta dhe rialokimi i buxhetit, lënë më pak mundësi për të krijuar hapësirë fiskale. Pavarësisht këtyre kufizimeve, konsideratat strategjike në lidhje me prioritetet politike në raportin e vitit 2021 mbeten në thelb të vlefshme. Duhet theksuar se zgjerimi i mbulimit me sigurime shoqërore kontributive mbetet një nga opsionet më të besueshme për krijimin e hapësirës fiskale për mbrojtjen sociale. Në varësi të kushteve makroekonomike për periudhën pas pandemisë, mundësia për qeverinë për të zgjeruar më tej hapësirën fiskale për mbrojtjen sociale është ende një mundësi e arsyeshme dhe praktike.

Në funksion të rolit vendimtar të sistemit të mbrojtjes sociale për mbrojtjen e jetës së njerëzve në rastin e goditjeve të paprecedentë si kriza e shkaktuar nga COVID-19, Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të realizuar objektivin afatgjatë që ka të bëjë me garantimin e mbrojtjes sociale universale. Për këtë qëllim, qeveria në nivel qendror dhe lokal duhet të shqyrtojë të gjitha opsionet e mundshme fiskale. Grupi i opsioneve alternative politike duhet të vlerësohet duke marrë parasysh ndikimin e tyre social, risqet dhe kompromiset, dhe të diskutohet me të gjitha palët e interesuara për të arritur konsensus mbi bazën e dialogut kombëtar.

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) beson se analiza e hapësirës fiskale shërben për të ofruar informacion të dobishëm sasior për të motivuar dhe për të zhvilluar diskutimin në aspektin e politikave. ILO, së bashku me organizatat partnere të OKB-së, janë të përkushtuar që të përfshihen aktivisht në diskutimin kombëtar për krijimin e hapësirës fiskale për mbrojtjen sociale universale dhe, për më tepër, për arritjen e Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

ilo.org/budapest

International Labour Organization
Central and Eastern Europe
Mozsár utca 14
Budapest H-1066
Hungary

 facebook.com/ilocentraleasterneurope

 twitter.com/ilo_CEE

 ILOTV

